



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Nr. ... Prot.

Tiranë, më 23. 03. 2017

LËNDA: KTHIM PËRGJIGJIE

DREJTUAR: QENDRA "RES PUBLICA", (person juridik i regjistruar në gjykate me Vendim Nr. 604, dt. 13.04.2014)

I nderuar Z. MATLIJA,

Në vijim të shkresës tuaj me Nr. prot 033/17 që është depozituar në rrugë postare, pranë "Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", me datë. 23, Mars 2017, lidhur me kërkesën për t'ju vënë në dispozicion, bazuar në Ligjin Nr. 119/ 2014, datë 18.09.2014 "Për të drejten e informimit" dokumentat:

1. Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kryer nga Kontrolli Latrë i Shtetit ndaj Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit gjatë vitit 2013;
2. Kopje të të gjitha informacionieve të mëvonshme që Agjencia e Kërkimit Teknologjisë dhe Inovacionit ka raportuar në KLSH për përmbushien e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, për auditimin e bërë në këtë institucion gjatë vitit 2013.

Në zbatim të, Neni 10, të Ligjit Nr. 119/ 2014, datë 18.09.2014 "Për të drejten e informimit" Ju bëj me dije si më poshtë:

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë e Inovacionit (AKTI) është krijuar me VKM Nr. 903 datë 26.08 2009 dhe ka qenë institucion në vartësi të Këshillit të Ministrave.

Ajo ka funksionuar me këtë emërtim që nga 26.08.2009 deri në miratimin e VKM Nr. 607 datë 31.08.2016, ku si rrjedhojë e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë" dhe në zbatim të Nenit 12, u ristrukturuam si institucion, duke kaluar në vartësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me emërtimin "Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit" – AKKSHI.

Aktualisht ndodhemi në procesin e zhvendosjes, nga Godina e Inovacionit, pasi ambientet që na përkasin në Godinën e Inovacionit (ish-INSTAT), i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi

“Agjencisë së Informacionit Gjeohapësinor” – ASIG, institucion në vartësi të Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike.

Në këto kushte, i gjithë dokumentacioni, duke përfshirë edhe atë në kërkesën tuaj, është i vendosur në kuti të arkivuara, në pritje të zhvendosjes në ambientet që do të na ofrojë Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucion prej të cilit varemi që prej datës 31, Gushtit 2016.

Për këtë arsye do të kërkonim mirëkuptimin tuaj që në pamundësi praktike për të ofruar në këtë moment informacionin që kërkonte, t’ua bënim të mundur atë, sapo të sistemohemi në ambientet e reja, ku do të ushtrojë funksionin Agjencisë Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit – AKKSHI.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin.

Me respekt,

Znj. Evis **TASELLARI**

Shefe e Sektorit të Marrdhënieve Bilaterale

(Koordinatori për të Drejtën e Informimit)-

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit